REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 124/17
Date/Datum. 21.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Policia e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

214	**16**	**134**	**111**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me jelek anti - plumb-Rivlerësim**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

SODEX GROUP SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

FEHMI AGANI 36
(Adresa)

PRISHTINE — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 148 184 — ***N/A***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

LUAN AVDIU
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
OFFICE@SODEX-KS.COM , INFO@SODEX-KS.COM
(Adresa elektronike)

20.04.2017
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH. P. K. SODEX GROUP NR.F:600755336 -1- PRISHTINË

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)
N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues:	Policia e Kosovës
Nr. i Prokurimit:	PK214-17-134-1-1-1
Lloji i kontratës:	1 - Furnizim
Vlera e kontratës:	1 - E madhe
Procedura:	1 - Procedurë e hapur
Tipi i njoftimit:	Njoftim për dhënie të kontratës
CPV:	28000000-2
Data e publikimit:	31-Mar-2017
Data e skadimit:	08-Apr-2017
Titulli i shpalljes:	Furnizim me jelek anti - plumb-Rivlerësim B08 Njoftim per dhenie te kontrates Furnizim me jelek anti - plumb.docx
Notice Title:	Supply of bullet proof vest-Rivlerësim B08 Contract Award Notice Supply of food to Kosovo Police.docx
Titula Nabavke:	Nabavka prsluk – olovo-Rivlerësim B08 Obavestenje o dodeli ugovora Nabavka prsluk - olovo.docx
Ri-Tenderim:	
Vazhdim Afati:	

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Kjo kërkesë për Rishqyrtim bëhet pas Rivlerësimit të Aktivitetit në fjalë me vendim të OSHP-së 294-297/11, datë 11.11.2016. Megjithatë, në procesin e hapjes kemi patur përfaqësues të pranishëm në hapje dhe NUK ishte evidentuar ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Kompania jonë pas pranimit të Letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm (B46), ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe me te konstatuar shkeljet dhe/ose shpërfilljet e AK-se në këtë aktivitet të prokurimit ne afatin ligjor më 05.04.2017 ka paraqitur pranë AK-së Kërkesën për Rishqyrtim duke përdorur F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK. Në këtë kërkesë (shih Aneksin E) kemi paraqitur dhe dëshmuar pretendimet dhe konstatimet tona lidhur me shkeljet e AK-së gjatë Rivlerësimit të Aktivitetit në fjalë duke u bazuar në Kërkesat e vet AK-së të parashtruara ne Dosje të Tenderi dhe FDT dhe të mbështetura në Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Mbase këto pretendime nuk ishin të bazuara për AK-në, dhe rrjedhimisht kjo e fundit përmes Vendimit të dt13.04.2017 refuzon si te pabazuar Kërkesën tonë për rishqyrtim (shih Aneksin F).

Pa dashur të prejudikojmë nëse AK ka ofruar arsyetim adekuat për pretendimet e OE tjerë ankues (Poligoni i Shenjëtarisë Katana në këtë rast), konsiderojmë se AK nuk ka ofruar arsyetimin e mjaftueshëm e aq me pak të bazuar dhe nuk ka mbështetur në LPP refuzimin e pretendimeve tona ankimore lidhur me:

1. **Shkelje e nenit 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
   Sepse, AK si arsyetim për këtë shkelje ofron interpretimin e gabuar të dispozitave ligjore te LPP-se, meqë arsyetimin i pabazuar i ofruar për ketë pikë përbën shkelje të dispozitave të Nenit 56, 59 dhe 60 te LPP-së
2. **Shkelje e Nenit 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
   Sepse, AK në arsyetim shkruan se OE i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të ofruara është i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht, por nuk argumenton shkeljet e pretenduara në Kërkesën për Rishqyrtim dhe nuk arrin të dëshmojë dorëzimin e dokumenteve (dëshmitë) e kërkuara në Seksionin e FTD-së (Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik), që kërkohet të dorëzohen para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës (Dokumentet nën nenin 6.4b Vërtetim nga Administrata Tatimore dhe 6.4c e FDT-së Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal / kopje e noterizuar),
   Dokumentet (nën 2 dhe 3) duhet të dorëzohen nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.
3. **Shkelje e Nenit 59.4 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
   Sepse, AK në arsyetim shkruan se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar mostrat të njëjta të përshkuar edhe në katalogun e ofruar në DT. Edhe pse ky arsyetim për piken a) është i pabazuar, konsiderojmë se AK nuk ka ofruar fare arsyetim për pretendimin tonë nën piken b) se nga OE i rekomanduar për kontratë Certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e

produkteve janë ofruar për produkte tjera nga ato të cilat janë sjellë si mostra për vlerësim. Për me tepër certifikatat e ofruara NUK PËRPUTHEN as me katalogët e ofruar, sepse në katalogun e ofruar trashësia e pllakës balistike niveli 4 është ofruar 23mm ndërsa NUK ofron as Certifikate balistike as Raportin testues për këtë pllakë. Disa raporte tjera janë prezantuar për pllaka balistike tërësisht tjera dhe me trashësi prej afro 18mm.

4. **Shkelje e Nenit 60.1 - Kriteret për Dhënien e Kontratës**
   Sepse, AK arsyeton se ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë, duke shpërfillur të gjitha shkeljet e pretenduara dhe argumentuara në Kërkesën tonë për Rishqyrtim. Duke marr parasysh konstatimet tona te bazuara në faktet e sjella në Kërkesën për rishqyrtim OE i rekomanduar me kontratë është i papërgjegjshëm dhe do të duhej të eliminohej që në fillim dhe rrjedhimisht Autoriteti kontraktues do duhej t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
5. **Shkelje e Nenit 71.4 - Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik"**
   Sepse, AK arsyeton se Tenderi i dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha kërkesat në bazë të ligjit, por dështon të argumentoj faktet se njëri anëtar i grupit të operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë (Seyntex SA) dështon të dorëzoj dëshmitë e përshtatshmërisë profesionale siç kërkohet në FDT neni 7.2 pika 1 dhe e paraparë me Nenin 66.1 të LPP-së, por edhe dëshmitë e kërkuara ne Seksionin e FTD-së (Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik), që kërkohet të dorëzohen para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës (Dokumentet nën nenin 6.4b dhe 6.4c e FDT-së)

6. **Shkelje te Nenit 13.4 " Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik"**
   Sepse, AK arsyeton se të gjitha dokumentet e kërkuara për kualifikim dhe specifikat teknike nga OE i rekomanduar kane qenë në gjuhet zyrtare, por nuk ka dashur të komentoje dhe aq më pak të ofroj arsyetim se dokumentet e dorëzuara nga njëri anëtar i grupit të operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë (Seyntex SA) përpos që nuk kanë qenë konform kërkesave të përshtatshmërisë profesionale, siç kërkohet në FDT neni 7.2 pika 1 dhe e paraparë me Nenin 66.1 të LPP-së, ato ishin të ofruara në gjuhën belge me një përshtatje të tekstit por **NUK** ka dorëzuar përkthim zyrtar në origjinal, të vërtetuar (nënshkruar e as vulosur) nga përkthyesit e licencuar në njërën nga gjuhet zyrtare të Republikës së Kosovës

<u>Lidhur me pretendimet ankimore të OE Poligoni i Shenjtërisë Katana se OE Sodex Group Shpk na qenka i papërgjegjshëm konform dispozitave:</u>

1. **NENI 69. Paragrafi 2. Pika 1**
2. **NENI 69. Paragrafi 2. Pika 4**
3. **NENI 69. Paragrafi 2. Pika 5**

Konstatojmë si në vijim:

Pretendimet sipas NENI 69. Paragrafi 2. Pika 1.

OE Sodex Group Shpk ka prezantuar me tenderin e saj edhe Garancionin prej 10 viteve te nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi siç kërkohej në dosjen e tenderit për materialin balistik dhe për KR1 (mbrojte nga therjet). AK NUK ka kërkuar që ky dokument të parashtrohet në origjinal, dhe rrjedhimisht në dosje është deponuar një kopje e këtij Garancioni, i adresuar për AK, në emër dhe me reference të projektit në fjalë, nënshkruar dhe vulosur nga vet prodhuesi.

Pretendimet sipas NENI 69. Paragrafi 2. Pika 4

modelet e ofruar nga OE Sodex Group Shpk janë:

- Concealed bulletproof vest – STEALTH
- Overt bulletproof vest – COMMANDER, including ICW Plates

Në Specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit, pesha maksimale për antiplumbin e brendshëm është përcaktuar të jetë maksimum 2,4kg. Tenderi i OE Sodex Group Shpk, në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit, për antiplumbin e brendshëm ka ofruar produktin e prodhuesit Safeguard Armour LTD UK, modeli Stealth, për të cilin në deklaratën e tenderuesit për Specifikacionet teknike thuhet se, së bashku me mbrojtjen kundër therjes, peshon me pak se 2,35kg. OE Sodex Group Shpk së bashku me tender poashtu ka dorëzuar edhe katalogun e produktit ne fjalë i cili konfirmon të njëjtat parametra dhe rrjedhimisht është konform Kërkesave të AK-së të paraqitura ne Aneksin 1 të DT-së.
Për më tepër OE Sodex Group ka prezantuar edhe mostrën fizike e cila dëshmon peshën prej me pak se 2,35kg, konform deklaratës se tenderit për specifikacione teknike dhe katalogut të ofruar.

Shënim me rëndësi:
Në uebfaqen dhe katalogun e Safeguard Armour shkruan se Jeleku peshon më pak se 2.5kg (less than 2,5kg), dhe jo ashtu siç përshkruan OE Ankues kur shkruan se peshon 2.5kg.

Për me tepër, siç mund të shfletohet edhe nga Ju të nderuar webfaqja e prodhuesit www.safeguardarmour.co.uk nuk është azhurnuar qe nga viti 2014-2015, kur edhe është ngarkuar (upload) katalogu i fundit i produkteve 2014-2015.

Meqë teknologjia është në evoluim e sipër, edhe jelekët antiplum janë gjithnjë e më të lehtë, përshirë këtu edhe modelet e ofruara nga OE Sodex Group të prodhuara nga Safeguard Armour LTD UK.
E gjithë kjo që u tha më lartë mund të konfirmohet me dokumentacion të prodhuesit por edhe me mostrat e prezantuara nga OE Sodex Group SHPK në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Në Specifikacionet teknike të Dosjes së Tenderit, pesha maksimale për antiplumbin e jashtëm, së bashku me dy pllaka balistike është përcaktuar të jetë maksimum 7,8kg. Tenderi i OE Sodex Group Shpk, në Aneksin 1. të Dosjes së Tenderit, për antiplumbin e jashtëm, ka ofruar produktin e prodhuesit Safeguard Armour LTD UK, modeli Commander, për të cilin, në deklaratën e tenderuesit për specifikacionet teknike thuhet se, së bashku me 2 pllaka te nivelit NIJ IV, peshon maksimum 7.75kg. OE Sodex Group Shpk së bashku me tender poashtu ka dorëzuar edhe katalogun e produktit në fjalë i cili konfirmon të njëjtat parametra, dhe rrjedhimisht është konform Kërkesave te AK-së të paraqitura në Aneksin 1 të DT-së.
Për me tepër OE Sodex Group Shpk ka prezantuar edhe mostrën fizike e cila dëshmon peshën konform deklaratës se tenderit për specifikacione teknike dhe katalogut te ofruar.



Shënim me rëndesi:
Në uebfaqen dhe katalogun e Safeguard Armour shkruan se Jeleku peshon me pak se 3kg (less than 3kg), dhe jo ashtu siç përshkruan OE Ankues kur shkruan se peshon 3kg.

Për me tepër, siç mund të shfletohet edhe nga Ju të nderuar webfaqja e prodhuesit www.safeguardarmour.co.uk nuk është azhurnuar që nga viti 2014-2015, kur edhe është ngarkuar (upload) katalogu i fundit i produkteve 2014-2015.

Meqë teknologjia është në evoluim e sipër, edhe jelekët antiplum janë gjithnjë e më të lehtë, përshirë këtu edhe modelet e ofruara nga OE Sodex Group të prodhuara nga Safeguard Armour LTD UK.
E gjithë kjo që u tha më lartë mund të konfirmohet me mostrat e prezantuara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Mbi të gjitha OE Ankues nuk ka përfillur faktin se Kompania Safeguard Armour është prodhues me renome në Mbretëri të Bashkuar (UK) dhe në Shtetet e bashkuara te Amerikës (USA), dhe se ofron zgjidhje për të gjithë konsumatorët, porse kërkesat e konsumatorëve (siç është rasti me AK Policia e Kosovës në Aktivitetin e prokurimit aktual) determinon çmimin, meqë sa me i lehtë që kërkohet të jetë Jeleku Antiplumi aq më i shtrenjtë është edhe çmimi, sepse përdoret teknologji tjetër, të cilën Safeguard Armour padyshim që e ofron, andaj dhe në uebfaqen dhe katalogun e tyre shkruan:

Citoj: "We offer a range of customizations to match your requirements"
http://www.safeguardarmor.com/media/wysiwyg/pdf/SafeguardArmor-Mini-Brochure-2014-15.pdf

Pretendimet sipas NENI 69. Paragrafi 2. Pika 5

Në Dosje të Tenderit, FDT, Neni 9.2, si dhe në Aneksi 1. Specifikacionet Teknike, lidhur me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nga AK janë parashtruar ndër të tjera këto kërkesa:

4. Certifikate dhe Raportin testues laboratorik për nivelin e mbrojtjes NIJ-IV (4) për pllakën e artikullit 2 (anti plumbi i jashtëm)
5. Certifikate dhe Raportin testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) për pjesën e bute balistike për te dy artikujt
6. Certifikatë për nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1 për artikullin 1 (anti plumbi i brendshëm)

OE Sodex Group Shpk ka ofruar konform kërkesave të AK te gjitha dëshmitë dokumentare (Certifikatat dhe Raportet testuese) si ne vijim:

Dëshmia Dokumentare 4:
Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IV (4) – kopje
- Certifikata nga Instituti i akredituar Amerikan për testimin e balistikes H.P. White Laboratory, Inc numër HPWLI000003349 dhe
- Atesti nr. 000003349 i dt. 23.09.2014

Dëshmia Dokumentare 5:
Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) – kopje
- Certifikata nga Instituti i akredituar Amerikan për testimin e balistikes H.P. White Laboratory, Inc numër HPWLI000004379A dhe
- Atesti nr. 000004379 i dt. 05.06.2015

Dëshmia Dokumentare 6:
Certifikatë dhe raport testues laboratorik për nivelin e mbrojtjes KR1 - kopje
- Certifikata nga Instituti i akredituar Amerikan për testimin e balistikes H.P. White Laboratory, Inc numër HPWLI000004851B dhe
- Atesti nr. 000004851 i dt. 24.09.2015

Pra të gjitha pretendimet ankimore ne Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga OE Katana <u>NUK</u> qëndrojnë për sa i përket OE Sodex Group Shpk.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pas qasjes në dokumente të tenderit kemi konstatuar se ka shkelje të LPP-së si në vijim:

7. **Shkelje e nenit 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
8. **Shkelje e Nenit 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
9. **Shkelje e Nenit 59.4 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
10. **Shkelje e Nenit 60.1 - Kriteret për Dhënien e Kontratës**
11. **Shkelje e Nenit 71.4 - Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik"**
12. **Shkelje të Nenit 13.4 " Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik"**
13. **Shkelje e Nenit 59 të LPP-se, gjegjësisht Neni 41 i UOPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Nga vet titulli i aktivitetit në fjalë shihet se kemi të bëjmë me një aktivitet të prokurimit i cili pas vendimit të OSHP-se Nr. 294-297/11, datë 11.11.2016 i është nënshtruar procesit të Ri-Vlerësimit.

Pas qasjes në dokumente të tenderit kemi konstatuar një mori shkeljesh së LPP-së si në vijim:

Përderisa në vlerësimin e këtij tenderi, me vlerësim meritor kompania jonë (Sodex Group SHPK) ishte vlerësuar si e përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit, gjatë procesit të rivlerësimit ndodh e kundërta. Autoriteti kontraktues jo që procedurën e prokurimit respektivisht Rivlerësimit nuk e ka zhvilluar drejtë dhe konform Vendimit të OSHP-së, duke i konfirmuar pretendimet tona lidhur me pretendimet dhe konstatimet e nxjerra se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, konsorciumi Allzone SHPK, Seyntex SA dhe PRICOM nuk i plotëson as përafërsisht kriteret e parapara në dosje të tenderit, Autoriteti Kontraktues shkon edhe me tej duke lënë të përgjegjshëm konsorciumi Allzone SHPK, Seyntex SA dhe PRICOM dhe duke nxjerrë të papërgjegjshëm kompaninë tonë me pretendimin se:
SODEX GROUP SHPK - Gjate procesit te ri-vlersimit kemi konstatuar se OE ne fjale nuk i përmbush specifikacionet teknike te detyrueshme. Jeleku antiplumb nuk ka te vendosura pjesët ngjitëse e as pjesët me mbishkrimin POLICE te cilat është dashur te jene te vendosura ne jelekun Anti Plumb ne pjesën e përparme dhe pjesën e pasme siç është kërkuar me specifika te detyrueshme.

Konstatim:
Përderisa specifikat teknike të detyrueshme ishin dhënë me të gjitha detajet, pikërisht për çështjen e Mbishkrimit POLICE nuk ishte dhënë asnjë specifikim i detyrueshëm, si:

1. Lloji i fontit (shkronjave)
2. Madhësia e shkronjave në pjesën e përparme
3. Madhësia e shkronjave në pjesën e pasme
4. Ngjyra e shkronjave dhe nëse shkronjat apo prapaskena duhet te jene fluoroscente
5. Pozicioni i mbishkrimit në pjesën e përparme
6. Pozicioni i mbishkrimit në pjesën e pasme

Andaj, në mungesë të këtij specifikimin kompania jonë në ofertën teknike dhe atë financiare ka konfirmuar se oferta përfshinë edhe mbishkrimin POLICE para dhe prapa, citoj: "**POLICE sign in front and rear included**".
Për me tepër kompania jonë ka dorëzuar pranë AK-së Deklaratën për specifikacionet teknike duke deklaruar dhe potencuar pikërisht për këtë arsye si në vijim:

Në rast të mos përputhjes së ndonjë mostre me specifikimet teknike të përmendura në aneksin 1 të kësaj dosje të tenderit, ne zotohemi që në rast të shpërblimit me kontratë do ti liferojmë mallrat sipas kërkesave në dosje të tenderit.

Për më tepër AK në raportin e Rivleresimit, tek Lista e plotë standarde për vlerësimin e përshtatshmërisë teknike të tenderëve (shih faqe 5 të Raportit të vlerësimit) nxjerrë kompaninë SODEX Group shpk si të përgjegjshme (shih kolonën e fundit TENDERI I PËRGJEGJSHËM në përputhshmëri me të gjitha kërkesat të përcaktuara në Dosjen e tenderit) në të cilën shënohet me "PO" (i përgjegjshëm).

Ky raport i vlerësimit vlenë të theksohet se është përpiluar më datë **14.11.2016** kurse vendimi, gjegjësisht Njoftimi është kumtuar vetëm më datë **31.03.2017**, plot 4 muaj e gjysmë pas vlerësimit. Ky fakt është i mjaftueshëm për të ngritur dyshimin e bazuar se AK gjatë gjithë kësaj kohe është munduar që të favorizojë Konsorciumin fitues në njërën anë dhe në anën tjetër të mundohet që përmes prolongimit të procedurës së tenderit të ndërlidhur me kosto shtesë për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe garancionin e tenderit në kosto prej 45,000.00 Euro për disa herë me radhë të bëjë që kompanitë tjera të heqin dorë nga ky aktivitet i prokurimit. Andaj konsiderojmë se edhe ky veprim i AK-së është në kundërshtim me LPP-në, dhe Neni 41 i UOPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Rrjedhimisht konsiderojmë se AK nuk i ka analizuar dhe vlerësuar në mënyrë meritore dokumentacionin dhe mostrat e dorëzuar me ofertën tonë.

****

PRETENDIMET LIDHUR ME OPERATORIN EKONOMIK TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, konsorciumi Allzone SHPK, Seyntex SA dhe PRICOM, tash e tutje të referuar si Konsorciumi, në njoftimin për dhënje të kontratës nuk i plotëson kriteret dhe kushtet e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit në më së paku pikat e poshtëshënuara:

Konstatimi 1:
Autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Ndër të tjera në specifikacionet teknike mandatore AK ka vendosur një limit në peshën e Antiplumbit të jashtëm në maksimum prej 7.8kg duke përfshirë edhe 2 pllakat balistike.
Ne konstatuam se Mostra e kërkuar nga AK dhe ofruar nga Konsorciumi i rekomanduar me kontratë peshonte më shumë se 8 kg, respektivisht 8.05kg (bashkangjitur foton) dhe rrjedhimisht konsiderojmë se Mostrat e ofruara nuk janë konform kërkesave dhe specifikacioneve teknike të parapara me dosje të tenderit. Autoriteti Kontraktues në disa emaila rradhazi ka kërkuar nga Konsorciumi plotësimin e dokumentacionit tenderues, gjithnjë duke u referuar si kërkesë për sqarime shtese.

Më dt. 02.12.2016 AK ka kërkuar nga Konsorciumi që kriterin e paraparë me Nenin 3.1 të FDT-së (Deklaratën për Specifikacione teknike) të e dorëzojë më së voni me dt. 07.12.2016. Kjo nuk është e lejuar me LPP-në për tenderat e dorëzuar fizikisht, siç ka qenë rasti i tenderit në fjalë.
AK ka vërtetuar edhe dokumentacionin e dorëzuar nga Konsorciumi dhe në përgjigjet që ka pranuar AK me rastin e verifikimit të Certifikatave dhe Atesteve të paraqitura nga Konsorciumi, në përgjigjen e dt. 25.11.2016 nga h.bakker@tno.nl konfirmohet se vetëm 2 Test Certifikata dhe një Deklarate Konformiteti janë origjinale, përderisa për raportet e testimit, deklaratat e konformitetit dhe certifikatat tjera me logo TNO ka marrë konfirmim se nuk janë lëshar nga institucioni TNO (shih bashkangjitur tabelën me certifikatat e dorëzuara nga Konsorciumi dhe emailin e dërguar nga h.bakker@tno.nl)
Nga këtu shihet se të gjitha certifikatat dhe atestet e TNO të cilat vet TNO nuk ka mundur të vërtetojë autencitetin e tyre, NUK mund të mirren për bazë dhe rrjedhimisht oferta është e papërgjegjshme.

Andaj, përpos qe AK nuk do te duhej që certifikatat e prezantuara (shih nënrenditur me poshtë) nga Konsorciumi te i vlerësoj si te përgjegjshme, do te duhej te kerkoje llogari per parashtrimin e certifikatave dhe atesteve te prezantuara autenciteti i te cilave nuk konfirmohet nga Laboratori TNO.

Atestet e pakonfirmuara nga TNO

07MB04752
07MB04753
14LBR/1244
15LBR/1596
12LBR/01156
12MB01633
12MB01974 / 12MB01980
12MB01975 / 12MB01981
12MB01976 / 12MB01978
12MB01977 / 12MB01979
12MB01982
12MB01983
12MB01985 / 12MB01986 / 12MB01987 / 12MB01988
12MB01989 / 12MB01990 / 12MB01991 / 12MB01992
14MB02709/14MB02710
14MB02711/14MB02712
14MB02839/14MB02840
14MB03126/14MB03127
14MB03128
14MB03129
14MB03130 / 14MB03131

Konstatimi 2:

Autoriteti kontraktues në nenin 9.1 pika 1 të FDT ka kërkuar

1. Katalog apo broshurë me ilustrime dhe foto me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike te ofruara.

Konsorciumi i rekomanduar për kontrate ka dështuar në këtë pikë pasi që nga katalogun dhe broshurat e ofruara mungojnë elementet bazë për vlerësimin e artikujve si:

- *mungon* modeli ne secilin artikull të ofruar
- *mungon* pesha e pllakës se ofruar
- *mungon* pesha e jelekut me balistike
- *mungon* informacioni për madhësitë e jelekëve siç janë kërkuar në Aneks 1

të gjitha këto janë elemente pa të cilat nuk mund të identifikohet artikulli e aq më pak të vlerësohet, andaj shihet se Konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar pikën e kërkuar, njëherit nga këto specifika as teorikisht nuk mund të determinohet pesha totale e produktit të ofruar, e që është njeri ndër kriteret e specifikimeve teknike.

Konstatimi 3:
Autoriteti kontraktues në nenin 9.1 pika 4 të FDT ka kërkuar
4: Certifikatë dhe Raportin testues laboratorik për nivelin e mbrojtjes NIJ-IV (4) për pllakën e artikullit 2 (antiplumbi i jashtëm).

Konsorciumi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar 3 test raporte për pllakë me numrat e test raporteve 07MB04750, 07MB0451 dhe 07MB04752 dhe nga ato shihet kjartë se pllaka e testuar ka këto karakteristika:

- Dimensioni është: 300x250mm
- Trashësia është: 18.69mm
- Pesha për testin 07MB04750 është: 3065 gram
- Pesha për testin 07MB04751 është: 3075 gram
- Pesha për testin 07MB04752 është: 3063 gram
- deri 3075gram

Njëherit OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar "katalogun" për pllakë të nivelit NIJ IV, me titull: HARD AMOUR PLATE ku shihet se:

- trashësia e pllakës se ofruar është 23mm
- nuk ka ofruar fare peshën e pllakës (gjë që është determinuese për kriterin e peshës së jelekut)

nga këtu shihet se test raportet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë fare nuk përkasin me katalog dhe me produktin e ofruar, që i bie se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka fare test raportet për produktin të cilin e ka ofruar, sepse testet e ofruara janë për produkt krejtësisht tjetër.

Konstatimi 4
Tek Aneksi 1 te specifikat e detyrueshme është kërkuar që duhet të plotësohet **Specifikacioni i ofruar nga OE (përfshirë Brendin dhe Modelin)**

Konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar fare Modelin, njëherit të gjitha specifikimet e tjera i ka kopjuar nga kërkesa e AK-se duke kopjuar çdo shkronje përfshirë edhe rreshtin informativ **"Design: Similar with attached photo (source internet)"**

Nga se u tha më lartë, **konstatimi 1-4,** konsiderojmë se AK nuk e ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në Dosjen e tenderit dhe si rrjedhoje ka bërë shkelje të:

- ***Nenit 7 "Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi"*** të LPP-se, sepse **ka favorizuar konsorciumin** "Allzone SHPK, Seyntex SA dhe PROCPM" **pasi që ka shpërblyer me kontrate OE të papërgjegjshëm;**

- ***Nenit 56, paragrafi 1.1 "Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave"*** **te LPP-së, pasi që përkundër faktit se Konsorciumi në fjalë nuk ka plotësuar specifikimet minimale të përcaktuara në Dosje të tenderit, të njëjtin ka shpërblyer me kontratë;**

- ***Nenit 59, paragrafi 4 " Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve"*** **të LPP-së,** pasi që në përputhje me këtë nen, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri

me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, ndërsa Konsorciumi i shpërblyer me kontrate ka dorëzuar tender jo në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara.

a) Mostrat e ofruara nuk përputhen me përshkrimin dhe prezantimet e produkteve që duhet të furnizohen, **meqë në mostër është ofruar tjetër artikull ndërsa në përshkrime tjetër,** dhe

b) **Certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve janë ofruar për produkte tjera nga ato te cilat janë sjellë si mostra për vlerësim**, njëherit nuk përputhen as me katalogët e ofruar dhe rrjedhimisht konsiderojmë se AK ka shpërfillur Nenin 59.4 te LPP-së.

- ***Nenit 60, paragrafi 1.1 "Kriteret për Dhënien e Kontratës"*** **te LPP-se,** pasi që në përputhje me këtë nen, Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërsa AK ka shpërblyer me kontrate Konsorciumin që ka dorëzuar tender të PAPËRGJEGJSHËM.

Konstatimi 5:
Anëtari i konsorciumit, kompania Seyntex SA, nuk ka dorëzuar dëshminë e përshtatshmërisë profesionale siç kërkohet në FDT tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.2 pika 1 - Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit, dhe e paraparë me ***Nenin 66.1 te LPP-së.***
Citoj: *"Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatojë aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend..."* dhe si rrjedhojë ka bërë shkelje ***të nenit 71, paragrafi 4, "Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik"*** pasi që në përputhje me këtë nen çdo kërkesë e vendosur sipas nenit 66.1 duhet të plotësohet nga secili anëtar i grupit.

Konstatimi 6:
Anëtari i konsorciumit, kompania Seyntex SA, ka dorëzuar disa dokumente në gjuhën Belge dhe nuk ka për to përkthim zyrtar të vërtetuar nga përkthyesit e licencuar në njërën nga gjuhet zyrtare të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhoje AK ka bërë shkelje të **nenit 13.4** ***"Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik"*** pasi që në përputhje me këtë nen *"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze"*

Konstatimi 7:
AK në FDT tek nenin 3.1, Specifikacionet teknike të detyrueshme nën piken a) ka kërkuar:
Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Konsorciumi i rekomanduar me kontratë **NUK** ka paraqitur fare Deklaratën e kërkuar sipas FDT-së.
Megjithatë, më dt. 02.12.2016 AK ka kërkuar nga Konsorciumi që kriterin e paraparë me Nenin 3.1 të FDT-së (Deklaratën për Specifikacione teknike) të e dorëzojë më së voni me dt. 07.12.2016. Ky veprim nuk parashihet me LPP-në për tenderat e dorëzuar fizikisht, siç ka qenë rasti i tenderit në fjalë dhe ekzistojnë praktika të mira të Vendimeve të OSHP-së kur pikërisht për mungesë të Deklaratën për Specifikacione teknike OE fitues është shpallur nga Vendimi i OSHP-së si i papërgjegjshëm. Ju lutem referojuni vendimit të OSHP-së 143/16 ku një OE është diskualifikuar pikërisht për mungesë të Deklaratës për Specifikacione teknike.

Konstatimi 8:
AK në FDT por decidivisht në Aneksin 1 - Specifikacionet teknike ka kërkuar:
Garancioni 10 vite për stab protection.

Garancioni i ofruar nga Konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka të përfshirë garancionin për **stab protection (mbrojtje kundër therrjes)**

Nga se u tha me lartë, **konstatimi 7-8,** konsiderojmë se AK nuk e ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në Dosjen e tenderit dhe si rrjedhojë ka bërë shkelje të ***Nenit 59, paragrafi 4 "Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve".***

GJATË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT, RAPORTI I TË CILIT KA PËRFUNDUAR NGA KOMISIONI VLERËSUES PREJ TRE ANËTARËSH ME DT. 14.11.2016 (SHIH FAQEN E PARË TË RAPORTIT), AK KA VAZHDUAR QË TË JUSTIFIKOJË DHE NXJERR TË PËRGJEGJSHËM KONSORCIUMIN DUKE KËRKUAR KËSHTU INFORMACIONE SHTESË EDHE ME DATË 07.12.2016, VEPRIM KY NË KUNDËRSHTIM TË PLOTË ME LPP-NË, RESPEKTIVISHT NENIN 41 I UOPP-SË - EKZAMINIMI, VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE.
PAS PËRFUNDIMIT TË VLERËSIMIT AK KA KËRKUAR NGA KONSORCIUMI QË TË SJELLË EDHE DOKUMENTIN "DEKLARATË PËR SPECIFIKIME TEKNIKE KONFORM KËRKESËS SË DT-SË. POASHTU KY AVAZ I KOMPLETIMIT TË DOSJES SË TENDERIT TË KONSOCIUMIT FITUES KA VAZHDUAR EDHE NË MUAJIN DHJETOR DUKE KËRKUAR NGA KËTA TË FUNDIT EDHE PËRSHTATSHMËRI TË PRODUKTIT DHE PESHËS SPECIFIKE TË JELEKËVE.

SHËNIM ME RENDËSI:
GJATË MATJES SË JELEKUT TË JASHTËM BALISTIK TË KONSORCIUMIT GJATË QASJES NË DOKUMENTE TË TENDERIT PAS RIVLERËSIMIT ËSHTË KONSTATUAR SE MUND TË JETË NDRYSHUAR MOSTRA, PËRFSHIRË PANELET BALISTIKE TË BRENDSHME DHE PLLAKAVE BALISTIKE.
JELEKU ME GJITHË PLLAKA KA PESHUAR 8.05KG GJATË MATJES SË PARË (DËSHMITË E TË CILAVE JU KEMI PREZANTUAR EDHE GJATË ANEKSES SË PARË), PËRDERISA MATJA E TANISHME REZULTON TË JETË

7.86KG (SHIH DËSHMINË AKTUALE).
********** **PRETENDIMET LIDHUR ME OPERATORIN EKONOMIK POLIGONI I SHENJTARISË KATANA** Gjatë qasjes në dokumente të tenderit patëm mundësinë që të evidentojmë edhe shkelje për sa i përket OE, që sipas Raportit të vlerësimit del të jetë i përgjegjshëm, duke përfshirë të paktën këto shkelje: 1. AK në FDT por decidivisht ne Aneksin 1 - Specifikacionet teknike ka kërkuar: **Garanci 10 vite për balistike dhe stab protection.** Garancioni i ofruar nga OE Katana nuk e ka të përfshirë garancionin për **stab protection (mbrojtje kundër therjes)** por vetëm për panelet balistike dhe pllakave balistike (citoj: "We do herby certify that the ballistic performanca of the ballistic inserts and plates are warranted for the period of 10 years from the date of purchase...") 2. OE Katana lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesinale, Neni 9.1 dhe 9.2, gjegjësisht kërkesës 6. Certifikatë për nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1 për artikullin 1 (anti plumbi i brendshëm) ka dorëzuar raportin e testimit Nr. 14S267-02#, por jo Certifikatën për nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1. Si rrjedhojë, AK duhet të eliminojë tenderin e OE Katana, ngase nuk i plotëson dispozitat e sipërpërmendura të LPP-së. ********** Për më shumë konsiderojmë se kompania jonë ka plotësuar në tërësi kriteret e parapara në dosje të tenderit, dhe njëherit ka ofruar çmimin më të lirë ndër ofertat e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit, andaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që: 1. **Të aprovoj në tërësi kërkesën tonë për Rishqyrtim konform Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.** 2. **Të anuloj njoftimin për dhënje të kontratës** 3. **Aktivitetin në fjalë të e kthej në rivlerësim** 4. **Të shpallë fitues kompaninë tonë si operatori ekonomik më i lirë ndër operatorët ekonomik të përgjegjshëm**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale tejkalojnë vlerën prej 200,000.00 Euro, pa llogaritur dëme të konsiderueshme materiale për shkak të fitimit të humbur dhe duke mos përfshirë konsulencën profesionale dhe të angazhimeve shtesë për grumbullimin e informatave lidhur me përpilimin e kësaj ankese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) një kopje e Kërkesës së kompanisë sonë për Rishqyrtim, dt. 05.04.2017
f) një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
g) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe